



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, të mbajtur më 02.12.2016,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Flamur Shala (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Abit Kastrati.

Munguan: Shaip Shabani (PDK) dhe Cuneyd Ustaibo (KDTP).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Halim Halimi, kryesues, duke e propozuar këtë

R E N D D I T E:

1. Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës;
2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja "Mati 1";
3. Propozimplani për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, lagjja "Dodona";
4. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant;
6. Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015/2016;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Kryetari, Shpend Ahmeti, bëri të ditur se taksat e ndërtimit janë përcaktuar në bazë të Ligjit të ndërtimit të Republikës së Kosovës. Këto taksa janë të përcaktuara në bazë të formulës, e cila përbëhet nga tre komponentë. Komponenti i parë është taksa administrative, komponenti i dytë është taksa infrastrukturë sociale, ndërsa komponenti i tretë është taksa e dendësisë së infrastrukturës teknike. Këto taksa janë të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Agim Gashi tha se si GP e kemi një dilemë, se ndoshta këto taksa e shtojnë shumë ngarkesën e kësaj natyre, pastaj kjo ndikon në jetën e përditshme, duke e ngritur koston në industrinë e ndërtimit, sidomos për qytetarët të cilët do të jenë blerës, por kjo nuk është arsye që do të mund ta pengonte një proces të miratimit të një rregulloreje që do ta kishte bazën ligjore.

Qëndron Kastrati u shpreh në përkrahje të propozimrregullores, por kërkoi nga ekzekutivi që në të ardhmen të bëjë një plan, sepse të ndërtosh në Prishtinë është jashtëzakonisht lirë, Në disa komuna të tjera leja e ndërtimit paguhet më shtrenjtë sesa në Prishtinë, andaj është sugjerim i GP-së që, në të ardhmen, të mendohet që të rriten më shumë këto taksa.

Lirak Çelaj, në emër të GP-së, tha se ne nuk do ta votojmë këtë propozimrregullore, sepse konsiderojmë që edhe ashtu është rritur taksa e tatimit në pronë, vazhdimisht ka vetëm rritje të koston, nuk ka ndonjë lëvizje tjetër. Nëse e rrisim edhe këtë tatim, do të ndikojë në

shtrenjtimin e m² të ndërtimit dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve. Ne konsiderojmë se nuk është e nevojshme që në këtë situatë të ngarkohen qytetarët edhe më shumë, sepse bizneset nuk do ta marrin mbi vete këtë barrë, por do ta llogarisin në m² dhe do të rritet çmimi blerës.

Mirlinda Sopi, në emër të GP-së, shprehu përkrahje për miratimin e propozimrregullores, duke e pasur parasysh se kjo rregullore bazohet në ligjin e miratuar nga Ministria e Mjedisit, dhe besoj se Kuvendi komunal e ka obligim që ta mbrojë atë ligj.

Imer Rusinovci tha se edhe ne si GP e mbështesim këtë rregullore, para së gjithash, për faktin se kjo mbështetet në legjislacion. Sa u përket taksave dhe tarifave, mendojmë se ato janë relative dhe nuk do të thotë se nesër, pasnesër nuk ndryshojnë, por gjithmonë në kontekst të mirëqenies së popullatës.

Feti Mehdiu mbështeti miratimin e këtij propozimi.

Abetare Fazliu e përkrahu miratimin e rregullores.

Visar Arifaj e mbështeti miratimin e propozimrregullores, por sa i përket tarifës së taksave, ai u shpreh se nuk është e lartë, përkundrazi, nuk duhet frikësuar nga taksat që shkojnë në buxhet të Komunës, sepse këto kthehen në të mirën e qytetarit dhe e obligon Komunën që të jetë më e përgjegjshme për mënyrën se si i shpenzon ato.

Nenad Miladinoviqi e përkrahu miratimin e propozimrregullores.

Shefki Gashi kërkoi të dijë se me këtë rregullore sa do të rritet taksa për blerjen e banesës, pra sa do të jetë dallimi prej pagesës që është me këtë rregulloren tjetër. Ai shprehu mendimin se paraprakisht duhet të shfuqizohet rregullorja paraprake.

Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, tha se neni 18 i propozimrregullores e përcakton shfuqizimin e të gjitha akteve të mëparshme që e kanë rregulluar këtë fushë. Paraqitja e kësaj në fund të rregullores, është në pajtim me teknikat e hartimit të akteve normative, d.m.th. paraqitja në fund, e jo në fillim të rregullores.

Laura Zherka kërkoi sqarim nga Zyra ligjore lidhur me nenin 4 të kësaj rregulloreje, ku kemi të bëjmë me marrëveshjen për infrastrukturë në mes të investitorit dhe Komunës. Në paragrafin 14.3, parashihen sanksionet për investitorin në rast se nuk i kryen obligimet, mirëpo nuk kemi sanksione, në fakt sanksione ose një afat kohor deri kur Komuna duhet t' i ofrojë investitorit infrastrukturën e nevojshme.

Lidhur me diskutimin e znj. Zherka, Ardian Olluri dha sqarime të nevojshme.

Muhamet Selmani tha se në këtë propozimrregullore flitet për një lloj tabele, që i klasifikon kategoritë dhe mënyrat e kalkulimit, por nuk po e shoh askund se si bëhet kjo, vetëm thuhet referoju tabelës. A ekziston ndonjë tabelë për këtë çështje, apo është kështu bllanko? Nëse ekziston, a është e mundur ta kemi ne dhe të shohim çka ka në të, ta analizojmë se si është përpiluar?

Kryesuesi konstatoi se me 33 (tridhjetë e tri) vota për, 8 (tetë) kundër (Blerand Stavileci, Egzona Podvorica, Flamur Shala, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Nura, Shemsi Veseli) dhe 4 (katër) abstencione (Besa Rafuna, Muhamet Selmani, Naime Osmani, Sokol Krasniqi), u miratua Rregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja “Mati1”.

Kryetari, Shpend Ahmeti, theksoi se i kemi marrë disa vendime nga Ministria, por janë jashtë afatit që është caktuar, që shqyrtimi i ligjshmërisë duhet të bëhet brenda 15 ditëve. Nga dita kur janë dërguar në Ministri, kanë kaluar më shumë se 25 ditë, kështu që tash vendimet e herës së kaluar janë në fuqi.

Arsyeja pse na i ka kthyer Ministria, neni 7, paragrafi 2 i Udhëzimit administrativ, pra thotë se në vendim është shkruar vetëm numri i udhëzimit që i është referuar, e nuk është shkruar edhe titulli i atij udhëzimi.

Kryesuesi pyeti se a e kërkon Ministria hartën zonale. Këtu ne duhet të ndalemi e të mendojmë se a është ky lëshim formal, apo material.

Agim Gashi theksoi se qëndrimi i GP të LDK-së për planet rregulluese tanimë dihet. Pavarësisht nga vonesa apo mos vonesa e Ministrisë, nuk e ndërron kuptimin reale në raport me ligjin që e rregullon këtë fushë. Nëse dikush i papërgjegjshëm nuk i përcjell procedurat brenda afatit ligjor, nuk do të thotë që duhet të pësojnë nivelet tjera shtetërore për shkak të asaj papërgjegjësie. Ne mbesim pranë qëndrimit tonë për ta respektuar Ligjin dhe plotësimin e kushteve ligjore, d.m.th. vlerën e hartës zonale dhe vazhdimin e procedurave të mëtejme për ndryshimin e planeve të hollësishme rregulluese, andaj dhe nuk do ta votojmë.

Qëndron Kastrati, tha se ne si GP kërkojmë ta dëgjojmë prezantimin, pastaj do të vendosim varësisht nga diskutimet dhe qëndrimet që kemi.

Ai u shpreh se nuk është e drejtë që subjekti i LDK-së dhe i PDK-së dalin jashtë dhe thonë se nuk jemi duke bllokuar asgjë, ndërsa në ndërkohë asnjë plan rregullues nuk është mundësuar të kalojë.

Lirak Çelaj theksoi se ne si grup e kemi diskutuar shumë herë këtë dhe tash po më duket kot me i përsëritur. Në parim pajtohem me atë që tha kryetari, se nuk është faji i Komunës, ligji e thotë ashtu, duhet të procedohet ashtu dhe të shkohet tutje. Nuk kemi ne çka të diskutojmë, t'i bëhemi avokat asnjë institucioni tjetër, ne duhet të jemi avokat të Komunës së Prishtinës, dhe ata individë të papërgjegjshëm le ta marrin përgjegjësinë, ose le të shkojnë me procedura gjyqësore. Janë institucionet tjera të cilat e marrin përgjegjësinë për këto gabime, kështu që në parim nuk jemi për me i penguar, vazhdimisht kemi thënë që të kalojnë dhe të diskutojmë konkretisht për këto gjëra. Në parim i përkrahim iniciativat, përmes së cilave bashkohen shumë pronarë dhe bëhet një plan më i gjerë, e jo vetëm në trojet që i kanë, ose me parcela të vogla. Do të ishte mirë, po që se ka mundësi administrata, edhe atë kopjen e memorandumit, të cilën e ka nënshkruar Shpend Ahmeti me ndërmarrjen "Tregtia", t'ua shpërndajë të gjithë asamblistëve. Konsideroj se është bërë shkelje procedurale ligjore, andaj unë mendoj se institucionet relevante duhet të merren me këtë çështje.

Mirlinda Sopi u shpreh se edhe ne i kemi ngritur të njëjtat shqetësime në lidhje me dokumentet dhe diskutimet që i ka pasur Ministria me Komunën. Kemi kërkuar gjithmonë që t'i kemi përpara, për faktin se kryesuesi gjithmonë jap interpretim tjetër në Kuvend, e kryetari tjetër.

Sa i përket kësaj pike, grupi ynë ka vendosur që të mos jetë bllokues. Çdo pikë që nuk po kalon në Kuvend, po shkakton telashe në qytet. Me shpresën që kjo pikë është vetëm për diskutim publik, dhe besojmë se Komuna do t'i inkorporojë të gjitha ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve në këtë plan, por edhe duke e ditur se kjo prapë do të kthehet në Kuvend, e përkrahim.

Imer Rusinovci, bëri të ditur se e mbështesin këtë propozimvendim. Ai u pajtua që të dëgjohet prezantimi lidhur me këtë, të dëgjohej edhe diskutimet tjera nga asamblistët, pastaj të merret vendimi përkatës.

Feti Mehdiu kërkoi që të përgjigjet kush është përgjegjës. Nëse organit të cilit i drejtohesh nuk të japë përgjigje brenda afatit të paraparë, këtu qenka 15 ditë, ditën e gjashtëmbëdhjetë je i lirë të veprosh ashtu siç e parasheh kërkesa. Ne do ta përkrahim këtë propozimvendim kështu siç është, por pas prezantimit mund të kemi mendim edhe më të mirë.

Abetare Fazliu tha se kjo duhet të kalohet dhe të mos ketë bllokim, në mënyrë që të shkojë në diskutim publik.

Visar Arifaj, lidhur me materialet që u përcillen këshilltarëve, i përkrahu shqetësimet e paraqitura nga parafolësit. Ndoshta do të ishte shumë e lehtë vetëm të paguhet një server, çoftë në drow books, apo në google, apo kudo, që nuk është ndonjë teknologji

shumë e avancuar, ku do të mund t'i kishim të gjitha dokumentet. Në këtë mënyrë do të mundësohej shmangia e një konfuzioni që shumë shpesh po na ndodh në këtë sallë. Sa i përket pikave për plane të hollësishme rregulluese, e përkrahu vazhdimin e diskutimeve.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmi, në mënyrë elektronike bëri prezantimin e Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes "Mati 1", duke i njoftuar të pranishmit rreth disa komponentëve më kryesorë të këtij propozimplani.

Laura Zherka tha se, para se të fillojë me sqarimin e shkeljeve ligjore që janë bërë në inicimin dhe hartimin e këtij dokumenti, mendoj që, së pari, ka bërë shkelje Komuna që ka filluar, që ka iniciuar hartimin e këtyre dokumenteve, pastaj shkelje ka bërë edhe Ministria që nuk ka kthyer përgjigje me kohë.

Këto plane është dashtë të iniciohen duke u bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor. Është shkelje e nenit 10, mbi përgjegjësitë e Kuvendit komunal, Ligjit për planifikim hapësinor.

Në fillim të këtij dokumenti, ku referohet se ku është bazuar ky dokument, shkruan Plani zhvillimor komunal, ndërsa i referohet Udhëzimit për hartimin e planeve rregulluese, jo Udhëzimit administrativ për plane rregulluese të hollësishme.

Inicimi i këtyre dokumenteve është jashtëligjor, prandaj unë do të votoj kundër.

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga znj. Zherka, **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, dha sqarime të nevojshme.

Feti Mehdiu, meqë ky akt shkon në diskutim publik, parashtroi këtë pyetje:

U cek se tri parcela janë të Agjencisë së Kosovës për Privatizim. Sigurisht, në atë mbledhjen që do ta kemi prapë këtë akt në dorë, besoj dhe shpresoj që të kemi një përgjigje.

AKP-ja prej kur e trashëgoi atë pasuri, e kujt ka qenë para se të bëhet AKP-ja pronare?

Muhamet Selmani tha se duke e pasur parasysh parcelën për të cilën po diskutohet, shtroj pyetjen: Pse nuk është zgjatur planifikimi i kësaj pjese deri në rrugën kryesore, deri atje poshtë, në fund? Pjesa e parcelave që janë mbrapa, nuk janë futur tri hapësirat që janë të rrethuara. Do të ishte mirë që kjo pjesa mbrapa mos të mbetet jashtë këtij plani, meqenëse ky plan është kaq i mirë edhe nëse e shohim prej hartës që po na prezantohet, aty brenda nuk ka ndërtesa, kryesisht janë disa shtëpi që janë të ndara prej rrugës. Meqenëse ky plan është më i veçantë dhe mund të jetë edhe më mirë, propozoj që të bëhet deri në fund të parcelës, meqenëse është mundësia të bëhet tani, pastaj do të jetë vonë.

Ylli Hoxha tha se këtu kemi një propozim, i cili për mua është i duhur, sepse e parasheh edhe shkollën, e parasheh edhe çerdhen, e parasheh edhe parkun, i parasheh edhe rrugët, pra është e kundërta e asaj që e kemi pasur deri tani, andaj duhet të deklarohe mi për këtë çështje. Ndonëse e kam përkrahjen për këtë projekt, mendoj se duhet ta aprovojmë si Komunë, pra e konsideroj të nevojshëm edhe njëfarë dakordimi për këtë. Nuk mund ta trajtojmë me teke, se po mundem me votuar kundër një propozimi, i cili mund të rregullojë një pjesë të qytetit. Është shumë e domosdoshme që ta kemi edhe deklarimin edhe arsyeshmërinë, por referimi për paligjësi tanimë është i vonuar, ka ndërruar situata, ky vendim është i ligjshëm. Ekziston një plan rregullues për këtë territor, ekziston edhe një plan zhvillimor, u lejon banorëve të hyjnë në aranzhmane ndërtimore. Do të thotë, është kërkesë e pronarëve të futen në marrëdhënie kontraktuale me kompaninë, nuk është kërkesë e Komunës. Komuna mund t'i përcaktojë kufizimet e ndërtimit, por vendimmarrjen përse, kush, cila kompani etj. është në vullnetin e banorëve.

Shefki Gashi shprehu mendimin se këto çështje duhet të shtrohen pa inate politike, pa inate individuale, pa interesa, edhe pse ka shumë shkelje, nuk është trajtuar prona komunale, nuk është trajtuar prona e AKP-së. Këtu është në pyetje një kompani që i ka 200-300 punëtorë. Janë më se njëqind e më tepër qytetarë që i kanë bashkuar pronat. Dikush ka atje më shumë prona, dikush ka më pak, dikush bën luftë prapë me i përvetësuar më shumë. Unë votoj ashtu siç ju e bini vendimin, por proceset me i ndalur për hir të inateve, nuk guxojmë, as prej PDK-së, as prej LDK-së, as prej LVV-së as prej askujt.

Flamur Shala u shpreh se ajo çka po na intereson të gjithëve, është se ka apo nuk ka shkelje ligjore. Edhe nëse Ministria e ka bërë atë gabim, apo atë lëshim, që me vonesë i ka kthyer këto vendimet për rishqyrtim, a duhet ne ta bëjmë gabimin që të procedojmë diçka të paligjshme, nëse është shkelur ligji që në fillim, në inicimin e çdo ndryshimi ose hartimi të planeve rregulluese, cilat do çofshin ato, sepse këto i rregullon Ligji për planifikimin hapësinor?! Besoj se edhe kryetari është i bindur, se nuk mund të bëhen ndryshime në planet rregulluese pa harta zonale, nuk mund të bëhen inicime të planeve rregulluese.

Visar Arifaj tha se sipas planit për të cilin jemi duke diskutuar, nuk po e shoh se ku po mbetet ai brez i gjelbër edhe qysh po inkorporohet sipas sipërfaqes që ka me përmbajt. Kërkoj sqarim se çka po ndodh me këtë perimetër, se edhe në krejt "Mati 1" është pjesa me më së shumti gjelbërim, kështu që nëse humb, nuk e di sa do të kishte kuptim. Kisha dashur një sqarim për këtë pjesën e perimetrit. Sa i përket anës ligjore, më duket se ne duhet të dalim dhe të shohim se çfarë efekti ka në terren, a duhet përcjellë në detaje se sa po respektohet ligji.

Sadri Ramabaja u shpreh, se tash bëhet viti i shtatë që jam në këtë asamble, ku na kanë ardhur shumë plane rregulluese, janë korrigtuar me dhjetëra plane të lagjeve të ndryshme etj., dhe unë kam ardhur në përfundim se kjo katrahurë në lagje të veçanta të qytetit, nuk është produkt i makutërisë së mafies së ndërtimit, por ju e dini se pjesë të përgjegjësive ka edhe ky Kuvend, sepse nuk ka se si të shpjegohet ndryshe rruga "Muharem Fejza", lagjet atje që krijojnë depresion të jashtëzakonshëm. Unë jam shumë i bindur se po të bëhej një studim i veçantë, siç është PISA, me karakter analitik, socio-politik, edhe psikik, një pjesë e mirë e fëmijëve që jetojnë në lagje të veçanta të Prishtinës, sigurisht nuk do të kishin rezultate pozitive.

Është hera e parë që na silltet një model i një lagjeje jashtëzakonisht të mirë, që përmbush shumë kritere edhe të karakterit social, edhe urban, edhe estetik, dhe ju jap mesazh ndërtuesve se si munden të bashkëpunojnë me qytetarët, ndërkaq qytetarëve një sinjal shprese se, megjithatë Prishtina mund të bëhet.

Shemsi Veseli shprehu mendimin se në procedurë paraprake ka pasur shkelje prej kryetarit, që ka keqpërdorur autorizimin e vet, kompetencën e vet, dhe e ka anashkaluar komplet këtë Kuvend, sepse paraprakisht është dashur ta marrë një miratim para se të nënshkruhet një memorandum i tillë.

Realisht, ky memorandum është bërë më 25 qershor 2015, me ndërmarrjen tregtare, gjegjësisht punuese "Tregtia", dhe në këtë aspekt unë mendoj që janë tejkualuar autorizimet dhe përgjegjësitë e kryetarit, sepse Kuvendi është i vetmi organ që mund të vendosë për pronat e Kuvendit komunal, gjegjësisht të Komunës së Prishtinës.

Në këtë rast, faktikisht po bëjmë degradim të planit të tërësishëm.

Sylejman Pireva u shpreh se, duke i dëgjuar kolegët e mi lidhur me formën dhe përmbajtjen e gjithë këtij projekti goxha madhor dhe interesant, po vërej që po i shihet për të madhe një defekti nga ana formale dhe asgjë nga ana përmbajtjesore.

Kur shohim këtu interesin madhor, përfitues janë qytetarët, atëherë është e pakuptimtë që për shkak të një forme, u dashka të sakrifikohet një përmbajtje thelbësore kaq interesante, e me këtë sakrifikohen edhe qytetarët tanë, kjo më duket pak absurde.

Lidhur me pyetjet dhe dilemat e parashtruara nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Burbuqe Hydaverdi**, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit.

Kryesuesi konstatoi se më 13 (trembëdhjetë) vota për, 8 (tetë) kundër (Agim Gashi, Egzona Podvorica, Halim Halimi, Laura Zherka, Muhamet Nura, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli) dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime (Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Genc Sherifi, Hasime Krasniqi, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Imer Rusinovci, Kreshnik Ahmeti, Merita Surkishi, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Qëndron Kastrati, Sadri Ramabaja, Teuta Krasniqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi, Ylli Hoxha), nuk u miratua Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të

Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja “Mati 1”.

Pika e tretë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1 të lagjes “Dodona”.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se qëllimi është që të bëhet një zgjidhje e pranueshme për banorët që përfshihen në këtë bllok. Kemi pasur disa takime me përfaqësuesit e Ministrisë, dhe herën e fundit kam qenë bashkë me banorët në Ministri, ku u është thënë se ka probleme ligjore, sepse PZHU-ja e ka koeficientin 1.8, nuk lejohet ndërtim ashtu si ka qenë përpara. Këtë propozimvendim, me kërkesë të banorëve, e kam sjellë në Kuvend për ta analizuar mundësinë e një zgjidhjeje. Edhe kësaj radhe kërkoj nga Lëvizja Vetëvendosje për të abstenuar.

Agim Gashi tha se qëndrimi i GP-së për këto propozimplane nuk ndryshon, është i njëjtë si më parë.

Lirak Çelaj tha se ne në parim e përkrahim. Arsyet kryesore që e përkrahim janë banorët e kësaj lagjeje, me shpresën se do t’u bëhet zgjidhje. Në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa, kam kërkuar nga drejtori dhe më ka thënë që ata janë pjesë e marrëveshjes, pastaj edhe i takova këtu në korridor dhe më thanë që janë të pajtimit, andaj duhet t’u bëhet zgjidhje, sepse atyre u është bërë një e padrejtë e madhe nga qeverisja paraprake, e që ka vazhduar edhe nga qeverisja aktuale. Mendoj se duhet t’u bëhet një zgjidhje qytetarëve të Prishtinës. Nuk është faji i tyre, ata janë vënë në lajthitje. Ata të cilët i kanë vënë në lajthitje, le të japin përgjegjësi. E përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Mirlinda Sopi tha se si GP, që nga fillimi kemi qenë pro këtyre lagjeve, e aq më tepër tash që është lagjja “Dodona”, ku këta qytetarë padrejtësisht janë duke pësuar, probleme këto që kanë filluar nga qeverisja e kaluar dhe vazhdojnë edhe tash. Edhe ne si grup i AKR-së, vetëm për këtë fakt votojmë pro, vetëm që t’u bëhet zgjidhje këtyre qytetarëve. Këta banorë tash jetojnë me qira dhe nuk ka të drejtë ky Kuvend, e as ndonjë investitor tjetër, me i penalizuar deri në këtë ditë. I ka vënë dikush në lajthitje, por ky Kuvend e ka obligim t’ju bëjë zgjidhje, e jo tash me bërë luftë politike po abstenojmë, apo po votojmë pro. Ne si grup bëjmë thirrje që t’u bëhet një zgjidhje këtyre qytetarëve.

Imer Rusinovci kërkoj nga asamblistët që të votojnë plotësisht të pavarur, pa imponime, pa udhëzime, pa rekomandime, por të jenë krejtësisht të pavarur.

Feti Mehdiu u shpreh se ne kemi kërkuar që Ministria, e cila e bën mbikëqyrjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, ta bëjë vlerësimin me notim, nga nota një deri në

pesë, për punën që jemi duke e bërë. Kjo nuk ka ndodhur deri tash, prandaj grupi im këtu e tutje e vlerëson se e kemi notë të dobët, por këtë pikë të rendit të ditës do ta votojmë për hir të qytetarëve të ngratë të cilët na kanë zgjedhur. Ky është mendimi ynë, ne do ta votojmë.

Abetare Fazliu shprehu mendimin se kjo pikë duhet të kalojë, të mos bllokohen qytetarët, sepse ata po pësojnë pafajsisht. Duhet të jemi të gjithë në mbështetje, që të kalojë dhe të votohet.

Visar Arifaj e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Qëndron Kastrati tha se ne si grup do ta respektojmë sugjerimin e kryetarit, përveç në rast se në Kuvend ka konsensus të plotë për këtë çështje. Siç u pa, vetëm Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është për, e për neve janë shkaktarët kryesor të asaj gjendje që është krijuar aty edhe që janë mashtruar ata qytetarë. Ato ndërtesa, ato lokale janë të rrënuara me mjete të Komunës, marrëveshja me qytetarë - pronarë është bërë në zyrat e Komunës, nga udhëheqja e Komunës, kështu që qëndrimi ynë është që të abstenojmë, përndryshe, nëse ka konsensus dhe të gjithë votojnë për, edhe ne do të votojmë për.

Flamur Shala theksoi se qytetarët e kësaj lagjeje, të cilët janë ulur këtu, disa prej tyre edhe po i njoh. Më vjen shumë keq prej tyre, sepse tash e sa kohë kanë mbetur në gjendjen në të cilën janë, por besoj se secilit prej nesh na vjen keq për këtë, pa përjashtime.

Ju them këtyre qytetarëve, qytetarë të vjetër të Prishtinës, për të cilën secili prej nesh kemi ndjenjë për qytetin e vjetër të Prishtinës, sidomos ata që kanë lindur dhe janë rritur këtu, e që një ndër ta jam edhe unë, të maltretohen në këtë mënyrë dhe të luhet politikisht në këtë mënyrë me ta, është e papranueshme.

Ky rend dite këtu është propozim i kryetarit të Prishtinës, është propozim i politikave të kryetarit të Komunës së Prishtinës, pra janë politikëbërje e kryetarit të Komunës së Prishtinës me ekipin e tij.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se këtë katrahurë e ka sjellë qeveria e mëparshme, e cila ua ka rrënuar shtëpitë këtyre qytetarëve dhe nuk u është bërë asnjë zgjidhje.

Muhamet Selmani u shpreh i kënaqur që po debatohet për zgjidhjen e këtij problemi të lagjes "Dodona", e veçanërisht kësaj pjesës që ka mbetur gjysmë e shëmtuar, përballë Parlamentit dhe Komunës. Uroj që kjo të zgjidhet sa më shpejt. Ne e dimë hallin e tyre, mirëpo ajo që po më pengon shumë, është njëfarë rivaliteti në mes dy grupeve, njëri që e ka bërë fajin, e tjetri që e ka prurë zgjidhjen dhe nuk donë të bëjnë zgjidhje.

I ftoj të gjithë asamblist që të reflektojë në zgjidhjen e kësaj pike dhe secili të mundohet ta japë më të mirën nga vetja për ta bërë një zgjidhje të tillë, e cila është e propozuar ose, nëse ka ndonjë zgjidhje më të mirë se kjo, të bëhet zgjidhje tjetër, e jo të abstenojmë apo të votojmë kundër.

Agim Gashi tha se LDK-ja asnjëherë nuk ka qenë kundër ndryshimeve, e as të ndryshimeve të planeve rregulluese. Ne kemi hezituar në votimin e tyre për shkak të reagimeve të Ministrisë, përkatësisht kthimit të vendimeve të Kuvendit si të jashtëligjshme, kemi dashur të respektojmë anën ligjore.

Në çoftë se kjo nuk do të vlente, LDK-ja nuk është kundër ndryshimeve dhe do ta votojë, do ta votojë për arsye se prapë ajo Ministri do ta ketë fjalën si mbrojtëse e ligjit, dhe e votuam apo nuk e votuam, nëse e kemi shkelur ligjin, ata do ta kthejnë negativ. Prandaj, ne sot po tërhiqemi nga fjala e parë dhe do ta votojmë.

Shefki Gashi theksoi se ky pajtim është një punë e mirë, por duhet kërkuar falje deri në qiell këtyre qytetarëve, se ka qenë një plan, ka qenë i përpunuar, i përgatitur sot e kësaj dite që dhjetë vite, apo 3-5 vite, apo që sa mbahet i anuluar, prandaj unë e përkrah fjalën e shefit të Grupit parlamentar edhe të grupit të LVV-së, se këta për të bërë përfitime politike, e kanë lënë atë vend ashtu si është, andaj kërkoj që ta votojmë këtë propozimvendim.

Laura Zherka tha se kryetari e ka problemin e këtyre banorëve që nga koha kur e ka filluar mandatin, të cilët vërtet janë në hall të madh. Qe tri vite është dashur t'u bëhet zgjidhje, mirëpo rastësisht ka ndodhur që zgjidhja e këtyre banorëve me ardhur njëkohësisht edhe me Planin paraprak, i cili dështoi për t'u votuar.

Zgjidhja e problemit për këta banorë ka mundur të shkojë shumë më herët, e jo këta me u maltretuar që dhjetë vjet, duke i pasur 3-4 zgjidhje, 3-4 propozime.

Kryesuesi tha se këta qytetarë janë maltretuar gjatë, por ndoshta i erdhi fundi maltretim të tyre. Mbetet të shikohet që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përkatësisht Ministria e Planifikimit, e merr vendimin në favor të tyre dhe thotë se nuk është shkelur ligji.

Visar Arifaj kërkoi nga kryesuesi që në nenin shtatë të propozimvendimit, aty ku thuhet afati kohor, të ceket afati se deri kur mund të kryhet, pasi që ashtu si është po mbetet disi e paqartë.

Sylejman Pireva tha se u zu në gojë këtu se kryetari është emocionuar edhe e ka tejkaluar, mund të them atë të kryetarit. Edhe unë pajtohem që nuk është mirë që një kryetar të emocionohet, por a ka shtytës që të ndikojë në emocionimin e njeriut, se më në fund edhe ai është njeri. Ta dini se duhet të kurseheni shumë prej këtyre, ka shumë çka pas asaj, është e pafalshme.

Kryesuesi konstatoi se më 37 (tridhjetë e shtatë) vota për, dhe 3 (tri) abstenimet (Flamur Shala, Imer Rusinovci, Rita Begolli), u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1 të lagjes “Dodona”.

Pika e katërt

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes “Prishtina e Re” – Zona Lindje.

Genc Bashota, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se fjala është për një sipërfaqe prej 109 hektarësh në lagjen “Prishtina e Re”, Zona Lindje. Aty janë tre pronarë dhe një pjesë të madhe e ka shteti, një pjesë të madhe relevante e ka Komuna, dhe një pjesë tjetër e kanë pronarët privatë. Ideja është për hartimin e Planin rregullues, sepse aty ka një s’përputhje në mes PZHU-së dhe Planit rregullues, mirëpo këtu nuk ka kërkesa që me shkuar më tutje me rritje të koeficientit më të lartë sesa që e kërkon PZHU-ja. Do të thotë, fjala është vetëm për shtrirjen e disa rrugëve, të cilat ato kanë një problem për me e trajtuar zonën urbane pa lëvizur asnjë koeficient.

Mustafë Krasniqi tha se qëndrimi i Grupit parlamentar të LDK-së është se e përkrah për disa arsye. Ne, pak më herët, në pikën paraprake e morëm një qëndrim të tillë, tani edhe në këtë rast po e përkrahim, nuk po e kundërshtojmë. Le të jetë në Ministrinë përkatëse për ligjshmërinë e këtij vendimi.

Qëndron Kastrati kërkoi interpretim nga Zyra ligjore, ose kushdo tjetër që përfshihet, se a është konflikt interesi me votuar kryesuesi, për shkak të lidhjes që ka me njërin prej pronarëve, nuk po supozojmë, nuk po parashikojmë, kështu e kemi një informatë për z. Maliqi, i cili është mik i kryesuesit. Vendimi i grupit tonë është, nëse ka vendim konsensual të Kuvendit, jemi për, përndryshe do të abstenojmë si dy rastet e kaluara.

Lirak Çelaj, tha se ne si GP i PDK-së në parim do t’i përkrahim planet urbane, se jemi akuzuar gjëja për bllokadë. Ne po themi se i pranojmë qe sa muaj, e tash po del e kundërta, nuk po di, pak po më shtinë në lajthitje, por në parim do ta përkrahim. Meqë u hap kjo temë, është mirë të na jepet neve lista e pronarëve, por edhe e investitorëve të mundshëm. Ai shtroi pyetjen se kush janë investitorët, a ka investitorë apo jo, vetëm me e pasur si informatë.

Mirlinda Sopi tha se ne si grup e kemi analizuar këtë dokument, në parim jemi për, meqë ky dokument është i bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor.

Feti Mehdiu, edhe ne e përkrahim, por le të mbetet hapur puna e disa dilemave që u shtruan, mund të verifikohen, por në parim ne do të jemi në ndihmë.

Visar Arifaj e përkrahu miratimin e këtij propozimi.

Ylli Hoxha ngriti një shqetësim rreth cilësisë së dokumentacionit, duke thënë se në momentin kur të na silltet dokumentacioni i tillë, të na silltet përmes një harte pak më të madhe, ku mund të dihet përafërsisht hapësira për të cilën po bëhet fjalë.

Laura Zherka e përkrahu mendimin e z. Hoxha, por kërkoi që të jenë të shënuara edhe ngastrat. Asnjë ngastër, edhe këtu në pjesën tekstuale, nuk është e shënuara për me ditur ku është lokacioni.

Agim Gashi u shpreh se profesori ka të drejtë, ai është vetë edukator dhe mirë që na këshillon kështu. Për ata që kanë fuqi dhe energji me e kuptuar se pronarë nuk është një edhe nuk përjashtohet mundësia që shumë prej asamblistëve kanë lidhje miqësore, familjare, po i lëmë ato gjëra, se askush në këtë rast nuk ka interes në atë punë. Mund të ketë ndoshta interes periferik në atë punë, të cilën nuk e dinë hiq, qëllimi është që ta shtyjme procesin, nëse na lejon Ministria.

Kryesuesi konstatoi se më 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 6 (gjashtë) vota kundër, (Agim Gashi, Egzona Podvorica, Halim Halimi, Imer Rusinovci, Laura Zherka, Shemsi Veseli) dhe 1 (një) abstenim, (Muhamet Nura), u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona lindje.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant.

Agim Gashi tha se GP i LDK-së është për miratimin e këtij vendim, mirëpo sa i përket varrezave, ne e kemi miratuar më herët një rregullore për mirëmbajtjen e varrezave. Ajo rregullore e obligon mirëmbajtjen, përkatësisht shërbimin përkatës, që t'i thurë varrezat, t'i mirëmbajë dhe të kujdeset për to. Kjo nuk është kompetencë e bashkësive fetare, por është kompetencë e Komunës së Prishtinës, sepse ato janë pasuri kulturore e qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Qëndron Kastrati tha se ne nuk jemi për ndarje të varrezave në baza religjioze. Konsiderojmë se do të duhej të kishim varreza të qytetit dhe në kuadër të tyre të respektohen ato hapësira. Por, sidoqoftë, për shkak të çështjes edhe ne do të votojmë, por të kërkojmë nga ekzekutivi që në të ardhmen ta kemi parasysh këtë politikë.

Lirak Çelaj theksoi se ne si grup e përkrahim, mirëpo mendojmë se është bërë një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut me vonesën edhe nga qeverisja paraprake, edhe

nga kjo e tanishmja. Derisa të realizohet ky projekt, është mirë t'u bëhet një zgjidhje, ky ka qenë qëndrimi ynë, në parim jemi për.

E dyta, ne kemi varreza të shpërndara nëpër qytet, i kemi në lagjen "Mati" dhe lagjet tjera. Unë nuk jam i kënaqur me vendin ku është zgjedhur, mendoj se është lënë pas dore sikur me qëllim. Janë futur me një vend të keq, d.m.th. unë po e shoh si pozitë, si territor diskriminuese.

Ky Kuvend e ka marr një vendim njëherë për një parcelë, ku është ndarë për kishë dhe varreza. Tani më parë duhet ta shfuqizojmë atë vendim, të votojmë njëherë për ta shfuqizuar, apo kur ta aprovojmë këtë vendim, të thuhet se ky vendim e shfuqizon vendimin paraprak?

Mirlinda Sopi, u pajtua me qëndrimin e z. Çelaj, të pakënaqur me parcelën, por përfaqësuesit e kishës janë dakorduar me përfaqësuesit e drejtorisë dhe është ndarë ky lokacion, i cili është në përputhje të plotë me Planin rregullues të lagjes ku edhe janë përcaktuar, kështu që në parim jemi për.

Rita Begolli u shpreh në përkrahje të vendimit.

Feti Mehdiu, bëri të ditur se si grup nuk e përkrahin dhe nuk do ta votojnë, sepse mendojnë se nuk do të jetë në të mirë të qytetarëve të Prishtinës për të ardhmen.

Abetare Fazliu tha se edhe ne e përkrahim këtë vendim për caktimin e lokacionit.

Visar Arifaj e përkrahu miratimin e vendimit.

Sadri Ramabaja u shpreh se fatkeqësia është se në shekullin 21, bimë në kundërshtim me frymën e shekullit 19 dhe japim fuqi juridike pikërisht vullneteve politike të atyre që duan t'i ndajnë shqiptarët. Për fat të keq, shumica islame, e kam fjalën për Bashkësinë Islame, e ka detyruar bashkësinë protestante që të kërkojnë një diçka të tillë, dhe kjo tash ka hyrë në agjendën politike. E dini që në një raport kemi gjykuar për këtë kështu, që le të konsiderohet si zgjidhje e përkohshme, sepse varrezat nuk janë as të krishtera, as myslimane, por janë varrezat e qytetarëve. Unë abstenoj, sepse nuk mund të votoj për ndarje të tillë.

Lirak Çelaj propozoi që në nenin 4 të shtohet pika 5, që rrethoja rreth kufirit të zonës kadastrale, d.m.th. krejt rrethoja qysh është edhe në varrezat tjera, dhe të shtohet edhe një nen, pas nenit të katërt, d.m.th. të bëhet neni 5, ku Komuna e Prishtinës merr përsipër kryerjen e punimeve, sepse siç është te varrezat "Hortikultura" që merret me mirëmbajtje, me mbjelljen e gjelbërimit që parashihet në këtë vendim, që ta marrë për sipër shfrytëzimin, d.m.th. Komuna për këtë investim dhe jo të ju lihet atyre. Ato rregulla që do të vlejnjë për varrezat e qytetit, të vlejnjë edhe këtu në njëfarë mënyre.

Kjo ishte sa i përket intervenimit, propozimit që e dhashë për me u futur në vendim. Unë vetëm po e ndiej një, meqë kam pasur disa takime me një përfaqësues të komunitetit protestant, një plotësim. Pajtohem plotësisht me atë që tha z. Ramabaja, edhe e ndaj të njëjtin mendim, të njëjtin qëndrim me atë që po thotë. Po dua të ju sqaroj se kjo nuk është kërkesë e komunitetit protestant që të ndahen, përkundrazi, ata janë për me qenë bashkë, por nuk ka qenë e gatshme Komuna me realizuar deri sot një projekt të tillë, ku varrezat e qytetit që janë, të krijojnë hapësirë për të gjithë, d.m.th. që është e drejtë qytetare, jemi shtet laik. Fatkeqësisht, ne sot në varrezat e qytetit e kemi vetëm një xhami, derisa të ndërtohen edhe kishat tjera, d.m.th. të tjera shtëpi kulti. Ne nuk mund të mendojmë se është realizuar ai projekt, le të realizohen, le të ndahen parcelat. Në parim unë besoj që shumica, nuk po them të gjithë, se nuk mund të them pajtohemi me këtë punë, por deri atëherë le të jetë kështu, se me të vërtetë kanë mbetur keq.

Ylli Hoxha tha se ne jemi duke ndarë lokacion, kjo që po propozon Liraku, është rregullim ekzekutiv i një vendimi, i cili ka edhe peshë financiare edhe punë, e cila nuk i përket këtij vendimi, prandaj konsideroj që atë mund ta diskutojmë në një propozim tjetër, por këtu nuk i përket këtij vendimi që ta rregullojë këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Feti Mehdiu, Imer Rusinovci, Kimet Zeqa) dhe 3 (tri) abstenime, (Muhamet Nura, Sadri Ramabaja, Shaip Hajrizi), u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant, me atë shtesën që u dha, pushon së vlejtuari vendimi i mëparshëm.

Pika e gjashtë

Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit 2015/2016.

Qëndron Kastrati tha se çështja e parë, është një çështje që e kam ngritur në Komitetin për Politikë dhe Financa, e kemi ngritur të gjithë dhe kemi qenë të pajtimit, e që ka të bëjë me materialin që na përcillet paralel me afatin kohor. Kjo është një prej materialeve që na ka ardhur me e-mail pak më vonë.

Edhe çështja tjetër është se, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër, sepse nuk ka kuptim të shqyrtohet në kohën kur drejtoresha e Arsimit nuk është e pranishme.

Agim Gashi theksoi se ka qenë traditë në Kuvendin komunal, që gjatë muajit shtator, eventualisht tetor, informata të përfshijnë jo vetëm suksesin e nxënësve të arritur në vitin paraprak, por edhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, sepse këto dy çështje kur e përmbyll një vit shkollor, përgatitesh paralelisht për fillimin e vitit tjetër. Informata, pjesa tjetër që unë desha ta ngriti, do ta plotësonte informatën e parë dhe do të tregonte nivelin, shkallën e arritshmërisë dhe në procesin e përgatitjes për fillimin e vitit të ri shkollor, sepse çdo vit që e lëmë pas, ai shkon me të arriturat e veta, ndërsa

për vitin tjetër përpigemi që ta shtyjme procesin përpara dhe të krijojmë kushte sa më të mira. Nëse shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, do të ishte mirë që Drejtoria e Arsimit, së paku me një informatë çoftë të hollësishme, çoftë në vija të trasha, të na njoftojë edhe rreth përgatitjes për fillimin e vitit të ri shkollor.

Lirie Avdiu theksoi se edhe ne mendojmë që, në mungesë të drejtoreshës, është më e arsyeshme që të shtyhet. Njëherësh kërkojmë që informatës për suksesin e nxënësve t'i bashkëngjitet edhe një informatë për punësimet e bëra kohën e fundit në këtë fushë dhe një raport për mungesat e nxënësve nëpër shkolla, në dy nivelet, fillor dhe të mesëm.

Mirlinda Sopi shprehu mendimin se ky dokument është pak i vonuar dhe, e dyta, drejtoresha nuk është këtu e pranishme.

Ajo kërkoj nga drejtoresha që t'ua sjell raportin e të punësuarve, sepse çdo ditë nëpër internet shihen artikuj që po paraqesin parregullsi në procesin e punësimit që po bëhen nëpër shkollat fillore dhe të mesme, por edhe për zgjedhjet e fundit të drejtorëve.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të kërkesave të grupeve parlamentare, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Sadri Ramabaja u shpreh i pajtimit që të shtyhet, por i sugjeroi drejtoreshës, meqë nuk ishte e pranishme, që ta ngre si shqetësim nivelin e takimeve me Ministrinë e Arsimit, pozicionin tepër të palakmueshëm që na ka rezervuar PISA në studimin e saj, që do të publikohet më dt. 6. Cilësia në nivelin e arsimit të Kosovës është e vlerësuar më e dobëta prej 68 shteteve që janë analizuar kësaj radhe, për dije që marrin nxënësit në fushën e shkencave natyrore dhe kompletimin e tyre për ballafaqim me jetën moderne.

Pika e shtatë

Pyetje dhe përgjigje.

Lirak Çelaj, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

A mundë të marrë një informatë me shkrim, se cila procedurë është zbatuar për dhënien e kioskave në këtë verë-dimër, në qendër, cilat kanë qenë kriteret, a ka pasur shpallje publike dhe cili ka qenë komisioni vlerësues?

Abetare Fazliu, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Kam një pyetje, apo një ankesë nga disa qytetarë, ku me rastin e festave të ndryshme, siç ishte festa e 28 Nëntorit, por edhe me rastin e organizimit të panairëve të ndryshme, qytetarët nuk po janë të lirë të kalojnë nëpër atë pjesë. Nga kjo dukuri qytetarët po kanë

pengesa, sepse mbeturinat po mbesin aty dhe askush nuk po merr përgjegjësi, ku qyteti po merr një pamje jo të mirë. Kërkesa ime është që të vendosen anash ose t'u caktohet një lokacion, e jo të vendosen në mes të sheshit.

Shefki Gashi, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Me rastin e festave, qyteti- qendra po merr një pamje jo të mirë nga ekspozimi dhe shitja e mallrave të ndryshme, andaj kërkoj nga kjo drejtori që ato objekte-qoshqe, të vendosen diku anash, që mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve, sepse kjo dukuri po i jep një imazh jo të mirë qytetit.

Shemsi Veseli, pyetje për Kryetarin e Komunës dhe për Zyrën ligjore.

Kërkoj nga Kryetari i Komunës që ta iniciojë procedurën për kthim në rishqyrtim të Vendimit për dhënien e lejes për Spitalit Amerikan, pasi që nuk janë përmbushur obligimet e parapara sipas kontratës nga palët që e kanë marrë në shfrytëzim. Po ashtu, kërkoj opinionin e Zyrës ligjore lidhur me kontratën, apo marrëveshjen që ka qenë për Qendrën Kardiokirurgjike, me të cilën kontratë vazhdon të punojë Spitali Amerikan, është e ligjshme apo nuk është e ligjshme.

Imer Rusinovci pyetje për ekzekutivin.

A ka mundësi që ky Kuvend dhe ju si kryesues, në bashkëpunim me ekzekutivin, duke e pas parasysh edhe gjendjen me këto paga të vogla që i kanë asamblastët, me ua blerë të gjithë asamblastëve nga një kompjuter.

Pika e tetë Të ndryshme

Lirak Çelaj tha se ne kemi diskutuar njëherë, në njërin prej seancave, për Qendrën e Fëmijës, të udhëhequr nga znj. Flora Brovina. Kemi kërkuar nga ekzekutivi, nëse nuk gabo, ka pasur konsensus prej të gjithëve këtu, dhe është obliguar në një mënyrë që ekzekutivi t'ua vazhdojë, dhe unë insistoj që kjo të zbatohet, të votojmë sot, apo ta përgatisim për mbledhjen e radhës. Mendoj se nuk është e drejtë që po i merret ajo qendër, e cila ka një histori, e ka një punë shumë të mirë, dhe është në dobi të qytetarëve dhe jo të individit. Mendoj se duhet ta trajtojmë si të tillë, pa marrë parasysh kush e udhëheq.

Qëndron Kastrati tha se sa i përket Qendrës së Fëmijëve, është e vërtetë që ka pasur konsensus në Kuvend që t'i ndihmohet asaj qendre, që t'i gjendet një lokacion, por duhet me e kuptuar, nuk mundemi ne, as ekzekutivi, nuk mundemi me marrë vendim për caktim të lokacionit pa propozimin e ekzekutivit. Çështja tjetër, nuk ka të drejtë as ekzekutivi me i ndarë lokacion dikujt, ose me ia vazhduar shfrytëzimin e një lokacioni pa ardhur prej

nivelit qendror. Kryetari e ka paraqitur para neve të gjithëve, se nëse vjen kërkesa prej nivelit qendror, ai e paraqet mundësinë e vazhdimit.

Qëndron Kastrati, vërejtje për ekzekutivin.

Me rastin e shënimit të festës së 28 Nëntorit, mirëmbajtja e flamujve kombëtarë ka qenë jashtëzakonisht e keqe. Mendoj se ka qenë shumë kohë e gjatë derisa është intervenuar për rregullimin e tyre. Duhet me qenë të kujdesshëm, që me flamurin kombëtar të mos ndodhin këso gjërash.

Lirak Çelaj, po ashtu ngriti shqetësim rreth vendosjes dhe mirëmbajtjes së flamujve me rastin e shënimit të 28 Nëntorit.

Hatixhe Hoxha, sa për informacion, tha se Qendra e Artit e ka pasur dokumentin që e ka marrë nga Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit. Tri kërkesa i ka pasur që ata i kanë bërë, plus objekti është i ndërtuar me mjete që Ministria e Kulturës i ka ndarë për atë objekt, vetëm po e sqaroj. Ndërsa, në anën tjetër, Qendra për Fëmijë e Flora Brovinës nuk e ka këtë status, pa dashur me replikuar, as pa dashur me treguar d.m.th. qëndrimin tim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

**Procesmbajtsja
Luljeta Selimi**